AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK), Tetor 2026

10.11.2026

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin tetor 2026, duke zbatuar klasifikimin e ri COICOP 2018, me vit bazë 2025 = 100 dhe metodologji të përditësuar.

Inflacioni mujor 0,0 %, ndërsa ai vjetor 7,1 %

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit ishte 0,0 % në muajin tetor 2026, krahasuar me muajin shtator 2026.

Ndërkaq, inflacioni vjetor ishte 7,1 % në muajin tetor 2026, krahasuar me muajin tetor 2025.

Tetor 2026 / Shtator 2026 0,0 %

Në muajin tetor 2026, Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) ishte 0,0 %, krahasuar me muajin shtator 2026.

Përkundër mos-ndryshimit në muajin tetor 2026 të Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit, krahasuar me muajin shtator 2026, vërehen disa ndryshime në grupet kryesore të COICOP-it, si: strehim, ujë, energji elektrike, gaz dhe lëndë të tjera djegëse (1,7 %); ushqim dhe pije joalkoolike (1,1 %); pije alkoolike, duhan dhe narkotikë (0,3 %); kujdes personal, mbrojtje sociale dhe mallra e shërbime të ndryshme (0,3 %); mobilje, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje rutinore shtëpiake (0,2 %); si dhe restorante dhe shërbime akomodimi (0,2 %).

Ndërkohë, rënie e çmimeve është regjistruar te grupet: transport (-2,2 %); rekreacion, sport dhe kulturë (-1,4 %); veshje dhe këpucë (-0,1 %); dhe informacion dhe komunikim (-0,1 %).


Tetor 2026 / Tetor 2026 7,1 %

Në muajin tetor 2026, Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK) është rritur për 7,1 %, krahasuar me muajin tetor 2025.

Rritja është ndikuar nga grupet kryesore të COICOP-it, si: transport (21,5 %); strehim, ujë, energji elektrike, gaz dhe lëndë të tjera djegëse (9,7 %); pije alkoolike, duhan dhe narkotikë (5,0 %); restorante dhe shërbime akomodimi (4,5 %); kujdes personal, mbrojtje sociale dhe mallra e shërbime të ndryshme (3,7 %); ushqim dhe pije joalkoolike (3,2 %); mobilje, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje rutinore shtëpiake (2,9 %); shëndetësi (2,9 %); veshje dhe këpucë (2,3 %); rekreacion, sport dhe kulturë (1,0 %); informacion dhe komunikim (0,7 %); si dhe sigurime dhe shërbime financiare (0,3 %).

Ndërkohë, rënie e çmimeve është regjistruar në grupin e shërbimeve arsimore (-0,3 %).

Norma mujore dhe vjetore e inflacionit në % e matur nga IHÇK



Ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në % për grupe dhe nëngrupe të COICOP-it

COICOP	Grupet dhe nëngrupet	Peshat 2026 në ‰	X - 2026 2025=100	X - 2026 IX- 2026	X - 2026 X - 2025
00	TË GJITHA ARTIKUJT	1000.0	108.4	0.0	7.1
01	Ushqime dhe pije joalkoolike	327.6	104.5	1.1	3.2
02	Pije alkoolike, duhan dhe narkotikë	57.6	106.6	0.3	5.0
03	Veshje dhe këpucë	42.6	102.9	-0.1	2.3
04	Strehim, ujë, energji elektrike, gaz dhe lëndë të tjera djegëse	94.1	113.3	1.7	9.7
05	Mobilje, pajisje shtëpiake dhe mirëmbajtje rutinore shtëpiake	77.7	103.7	0.2	2.9
06	Shëndetësi	29.6	105.0	0.0	2.9
07	Transporti	188.5	121.8	-2.2	21.5
08	Informacion dhe komunikim	39.6	100.5	-0.1	0.7
09	Rekreacion, sport dhe kulturë	29.5	101.8	-1.4	1.0
10	Shërbimet arsimore	8.3	100.2	0.0	-0.3
11	Restorante dhe shërbime akomodimi	43.1	107.1	0.2	4.5
12	Sigurime dhe shërbime financiare	19.2	100.4	0.0	0.3
13	Kujdesi personal, mbrojtja sociale dhe mallra e shërbime të ndryshme	42.6	104.7	0.3	3.7

Për më shumë informata, lidhur me publikimin e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin tetor 2026, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/PricesAndInflation